



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË

Nr. ____ Prot

Date _____.____.2025

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Date 10.09.2025

Drejtuar: Operatorit Ekonomik FREDI ELECTRONIC , NIPT K91803020F, Adresa : Rruga e Kavajes, 21 Dhjetori, P.207, Tirane.1001

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Tipi i kontrates: MALLRA

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar

Numri i procedurës REF-57944-08-12-2025

Përshkrimi i shkurtër i kontratës:

Objekti: Sistemi i votimit elektronik dhe transmetimit te rezultateve

Fondi limit: 2,750,000 (dy milion e shtateqind e pesedhete mije) leke, pa tvsh.

Afati: 45 dite kalendarike nga data e lidhjes të kontratës

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 13.08.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Datë 18.08.2025, Nr.44

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Subjekti FREDI ELECTRONIC, NIPT K91803020F me vleren:

2,623,400 (dy milion e gjashtëqind e njezete e tremije e katerqind) lek;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

2. Subjekti PC STORE , NIPT L01606034A me vleren:

2,614,000 [dy milion e gjashtëqind e katermbedhete mije] lek;

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

3. Subjekti NAOL, NIPT L92201032D me vleren:

0 (ZERO)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Subjekti PC STORE, NIPT L01606034A për arsye:

Operatori ekonomik nuk ploteson kriterin 2.2.2: Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme gjatë realizimit të objektit të kontratës, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme: - NS 13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. - NS 14 A Impiante te brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj Konkretisht, per plotesimin e ketij kriteri, operatori ka deklaruar si subjekt mbeshtetes shoqerine Martini Konstruksion & Real Estate. Subjekti mbeshtetes vendos ne dispozicion te ofertuesit licencen me 2 kategorite, NS 13 DHE NS 14, te kerkuara ne dokumentet e tenderit. Bazuar në neni 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” pika 2 paragrafi 4, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar: “Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor”. Ne rastin konkret, ofertuesi shoqëria “PC Store”, nuk ploteson 50% te kriterit te lidhur me disponimin e licences profesionale, pasi oferteusi nuk disponon asnje nga kategorite e licences te kerkuar ne dokumentet e tenderit. Bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit 162/2020 “Per prokurimin publik” dhe ne nenin 82 të VKM nr.285/2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” KVO skualifikon operatorin ekonomik.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin 2.3.2: Operatori ekonomik duhet te paraqese katalog/katalogje ose skeda teknike per te gjitha zerat e mallrave objekt ne kete procedure prokurimi, te cilat duhet te perputhen me pershkrimin e bere ne specifikimet teknike. Specifikimet e produkteve te meposhtme nuk perputhen me specifikimet e kerkuara ne dokumentet e tenderit. I.PAJISJE QENDRORE E KONFERENCES Kerkohet: Nderfaqe: RJ45 per protokoll TCP/IP. RS232, RS422,6*HDMI in,1*HDMI Out, 6 porta të zakonshme për lidhjen e kamerave, portë hyrëse për sinjalin audio, dalje (Mix Output) e sinjalit audio: Ne skedat teknike te dorezuara nuk ka dalje apo hyrje hdmi; Kerkohet: Reagimi i frekuencës: 40Hz-20kHz (-3dB); Nuk ploteson kerkesen per 40hz-20kh; Kerkohet: Fuqia maksimale: 350W ose me shume output; Eshte vetem 320W. Kerkohet: Lidhja me Mikrofonat: Lidhje nepermjet kabujve me 8pin ne seri per kualitet te zerit dhe menaxhim te kabujve; Lidhja e ofruar eshte me 6pine. 3. NJESI PJESEMARRESISH; KERKOHET: Lidhja 1. Fishe 8-pin DIN 2.Konektor per lidhjen e mikrofonave ne seri : Hyrje1 hyrje me ndërfaqe 8-pin Mashkull Dalje 3 dalje me ndërfaqe 8-pin Femër. Ofertuesi nuk ka cilesuar ne skedat teknike menyren e lidhjes se kerkuar. KERKOHET: Cilesime; Drita treguese: E kuqe gjatë fjalimit, e gjelbër kur dërgohet një kërkesë për fjalim. Funksione të integruara për fjalim dhe votim. Altolant HiFi me magnet

të integruar. Ekran LCD për rezultat votimi dhe ID mikrofon. 5 butona votimi. Mbështetje për gjurmim automatik të kamerës kur përdoret me kamera. Mikrofon me qafë të lëvizshme (gooseneck), i çmontueshëm. Gjatësia e mikrofonit gooseneck: Te pakten 300mm; Nuk ka butonat e kerkuar te votimit sic kerkohet: buton ndezje/fikje mikrofonit dhe 5 butona votimi. 5. AMPLIFIKATOR DIXHITAL PROFESIONAL; Ne katalog nuk ka specifikimet e kerkuara si me poshte: Dalje digjitale (Dante/AES67); 4 dalje digjitale në rrjet; Lexues audio; Player i integruar me slot MicroSD (deri në 2TB), formate të suportuara: mp3, wav, ogg, flac; Përpunimi i sinjalit (DSP); Matricë e brendshme 4x6, EQ parametrik, EQgrafik, limiters, delay, kompresor/limiter; Platforma e kontrollit Akses përmes aplikacionit Web të integruar + aplikacion për iOS/Android; Aftësi për kontroll të largët Po – përmes Ethernet dhe aplikacioneve mobile/web; Protokollet e rrjetit Dante / AES67, 4x Tx / 4x Rx (me rrjet primar dhe sekondar) 6. BOKSE MURAL AUDIO; KERKOHET: Gama e plotë 3"x4,2"x1; Ne skedat teknike është vetëm 1 8" dhe një twitter. 13. KABELL PËR MIKROFONAT E KONFERENCES 5M, 10M, 20M; KERKOHET: Kablllo Zgjeruese për Sistemin Inteligent të Konferencave; Kablllo me densitet të lartë 8-pin, e qëndrueshme dhe e besueshme; Njera ane Mashkull tjetra Femer për lidhje në seri; Kablli për lidhjen sic përmendet dhe tek specifikat kerkohet kabull me 8 pin jo me 6 pin sic janë ofruar. Bazuar në nenin 92, pika 3 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 82 të VKM nr.285/2020 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" KVO skualifikon operatorin ekonomik.

2. Subjekti NAOL, NIPT L92201032D për arsye:

Nuk ka dorezuar asnjë nga dokumentat e kerkuara dhe as ofertë ekonomike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ofertuesin FREDI ELECTRONIC, NIPT K91803020F, Adresa : Rruga e Kavajes, 21 Dhjetori, P.207, Tirane. 1001, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 2,623,400 (dy milion e gjashtëqind e njezete e tremije e katerqind) pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
SOTIRAQ FILO